



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 291 Prot.

Durrës, më 30.01.2026

V E N D I M

Nr. 7, datë 30.01.2026

PËR

"NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 8, DATË 10.02.2025 TË SENATIT AKADEMIK PËR "MIRATIMIN E KRITEREVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE PËR CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR, PROGRAMET E STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL 2-VJEÇAR, PROGRAM I INTEGRUAR I STUDIMEVE, CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE MASTER I SHKENCAVE DHE MASTER PROFESIONAL, PËR VITIN AKADEMIK 2026 – 2027, DHE KRITERET PËR PROGRAMET E REJA QË DO TË OFROHEN NË VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës".

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 64, VKM Nr. 407 datë 01.06.2016 "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitet akademike 2020–2021 dhe 2021–2022 e në vijim", i ndryshuar, në Urdhërin e MAS nr. 427, datë 04.09.2025 për miratimin e ofrimit edhe në gjuhën angleze të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Menaxhim Turizëm" me profil "Menaxhim Hotel Restorant"; në Vendimin nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik, si dhe në shkresën e Drejtorisë së Kurrikulave Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 286/1 Prot, datë 30.01.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në pikën 1 të Vendimit nr. 8, datë 10.02.2025 të Senatit Akademik, për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve Bachelor në "Menaxhim Turizëm" me profil "Menaxhim Hotel Restorant", program i ofruar në gjuhën angleze, për vitin akademik 2026 – 2027, në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim i bashkëlidhet dhe është pjesë e pandashme e Vendimit nr. 8, datë

10.02.2025 të Senatit Akademik.

3. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi ngarkohen:
- Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtoria e Kurrikulave, Cilësisë dhe Statistikave
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI



KRITERET E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË ÇIKLIN E PARË TË STUDIMEVE BACHELOR		
VITI AKADEMIK 2026 - 2027		
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës		
Cikli i studimeve	Programi	Kriteret e pranimit
Cikli i parë i studimeve (Bachelor)	Menaxhim Turizëm me profil: Menaxhim Hotel Restorant <i>në gjuhë Angleze</i>	<i>Si kriter përjashtues:</i> Të zbatohet vendimi i Qeverisë në lidhje me përcaktimin e kufirit të notës mesatare. <i>Si kriter përzgjedhës të pranimit të studentëve:</i> Maturantët do të vlerësohen sipas notës mesatare (të llogaritur sipas VKM^{es} në fuqi) në rend zbritës. Për aplikantët që vijnë nga Shkollat Profesionale Ekonomike, të aplikohet koeficienti 1.2. Gjuha e huaj anglisht niveli B1

